



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 114/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Loti I “Riparim dhe mirëmbajtjeje automjetesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me nr. REF-83258-12-28-2020, me fond limit 4,291,055 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.01.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
Adresa: Lagjia “Kryengritja e Fierit” Rr. “Aulona”, Fier.

Autoriteti kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nr. 3, Tiranë.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k
Adresa: Rr. “Enriko Telini”, Nd. 15, H. 1, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për

miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.12.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Loti I “Riparim dhe mirëmbajtjeje automjetesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””, me nr. REF-83258-12-28-2020, me fond limit 4,291,055 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.01.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 13.01.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor në datë

21.01.2021, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Vilnik Motors” sh.p.k.	2,770,300 lekë, Kualifikuar;
2. “Servis – Auto 2000” sh.p.k.	2,955,280 lekë, Kualifikuar;
3. “Alstezo” sh.a.	2,984,550 lekë, Kualifikuar;
4. “Auto Manoku Servis” & “Power Industries” sh.p.k.	3,305,900 lekë, Skualifikuar;
5. “Bushi - Servis” sh.a.	3,547,850 lekë, Skualifikuar;
6. “Kadiu” sh.a.	3,556,417 lekë, Kualifikuar;

II.4. Në datën 25.01.2021, operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k. dhe “Servis – Auto 2000” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]E kundërshtojmë këtë renditje në klasifikimin e ofertave të bërë nga AK, sepse lidhur me klasifikimin e Operatoreve VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000, pretendojmë që janë kualifikuar në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.9643 dt.20/11/2006 “PËR PROKURIMIN PUBLIK, i ndryshuar... si dhe V.K.M. Nr.914, dt.29/12/2014 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” i ndryshuar,.... pasi NUK plotesojnë të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Shtojcën 7, Kapitulli 2, KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

Konkretisht pretendimin tonë për skualifikim të këtyre operatorëve e mbështesim në arsyetimet dhe argumentimin, si vijon: Në dokumentet e tenderit në Shtojcën 7, Kapitulli 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, Pika 2.3 Për kapacitetin teknik , pika 2.3.5 dhe pika 2.3.7, nga ana Autoritetit Kontraktor është kërkuar përkatesisht, si vijon:

2.3Për kapacitetin teknik:

5. 5.Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

a)pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergencës) së rrotave të mjetit (autovetura, fuoristrada, mikrobuza etj).

b)pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);

c)pajisje diagnostikuese, të defekteve elektronike në mjete;

d)pajisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C;

e)pajisje për regjistrimin e ndriçimit të mjeteve;

f)pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;

g)pajisje urë ngritëse për automjetet, të paktën 2 (dy) ura;

h)pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorit;

i)pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;

j)pajisje për zëvendësimin e vajit të motorit;

k)pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit ;

l)pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.

m)Të ketë repart të riparimit të karrocërisë të mjetit (shasisë, tapicerisë dhe përpunimit të llamarinës) si dhe bojatisjes së mjetit të pajisur me :

-furre për lyerje me kapacitet për mjete (autovetura, fuoristrada dhe furgona);

-pajisje për drejtim shasie, të cilat të kenë kapacitet në përshtatje të plotë për realizimin e shërbimeve të mjeteve, sikurse kërkohet në specifikimet teknike ;

-reparti të jetë i kompletuar me pajisjet përkatëse (pajisjes poter për drejtim llamarinë, puntatrice, aparat saldimi, stukimi, pajisje zmerilimi dhe lucidimi).

Për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentet që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerjeje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorjeje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

7. Operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij.

A-Lidhur me pretendimin tone për mosplotësim të kërkesave të vendosura në Pikën 2.3.5, argumentojmë si vijon: Duke i njohur kapacitetet teknike të operatorëve ekonomik VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000, rezulton që të 2 këta operatore ekonomik nuk i disponojnë në FAKT në serviset e tyre përkatëse të gjitha pajisjet e kërkuara në pikën 2.3.5 në DST nga AK. Gjithashtu, nisur nga ky faktor, rezulton që të 2 OE : VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000 nuk kanë paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) të gjitha dokumentet që vërtetojnë se, të gjitha këto pajisje dhe instrumente sa me sipër i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerjeje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorjeje / kontratë dhurimi, çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, sikurse kërkohet në DST. Në kushtet e mësipërme, Operatorët ekonomik NUK i plotësojnë kërkesat e vendosura në Pikën 2.3.5, për “disponimin e pajisjeve dhe instrumenteve minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës”, të vendosura Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7, në DST nga AK

B-Lidhur me pretendimin tonë për mosplotësim të kërkesave të vendosura në pikën 2.3.7, argumentojmë si vijon: Nga informacionet që kemi nëpërmjet pjesëmarrjes në procedura të tjera me të njëjtat kërkesa dhe objekte të ngjashme prokurimi, si dhe duke i njohur kapacitetet tekniko-ekonomike të dy OE : VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000, rezulton që të dy operatorët ekonomikë të sipërpërmendur nuk janë importues direkt të pjesëve të këmbimit, por e mbështesin aktivitetin e tyre kryesisht në bashkëpunimet dhe në furnizimet me pjesë këmbimi për riparim të mjeteve brenda vendit. Në këtë mënyrë, këta operatorë në plotësim të kriterëve të vendosura në KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, Kapacitetit teknik Pikën 2.3.7, kanë paraqitur dokumentacionin e Autorizimit të Distributorit, përkatësisht nëpërmjet të cilëve ata furnizohen për nevojat e tyre lidhur me riparim të mjeteve. Nga ana tjetër nga AK është kërkuar në DST që „Operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mali, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij”. Në bazë të emërtesave dhe zërave të riparimit si dhe pjesët e këmbimit që kërkohen përkatësisht për montim gjatë kryerjes së këtyre riparimeve në mjetet e ndryshme të përshkruara në Shtojcën 10 të DT, rezulton që të dy këta OE nuk kanë paraqitur të gjitha dokumentet e plota (pra për gjithë pjesët e këmbimit që

konkurrojnë) me anë të të cilave, të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit... “ OE të sipërpërmendur kanë paraqitur autorizim të distributorit të pjesëve të këmbimit brenda vendit dhe në këtë rast, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Ndërkohë nga ana e AK NUK është verifikuar dhe nuk është provuar që të dy OE të plotësojnë kriteret e vendosura në pikën 2.3.7

Nga ana tjetër, përveç sa më sipër, distributoret nga ku furnizohen OE : VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000, nuk e provojnë me dokumente që e mbulojnë të gjithë gamen e artikujve me pjesë këmbimi të nevojshme për kryerjen e gjithë zërave të riparimit si dhe në pjesën më të madhe të artikujve NUK vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit” pra për të gjithë gamën e pjesëve të këmbimit, mjeteve të kërkuara përkatësisht në Shtojcën 10 të DT.

Përfundimisht, Operatorët ekonomik VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000 NUK plotësojnë kërkesat e vendosura në pikën 2.3.7

Sa me sipër duke ju referuar Ligjit Nr.9643 dt.20/11/2006 “PER PROKURIMIN PUBLIK, i ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr.10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr.22/2012, Ligjin Nr.131/2012, Ligjin Nr.182/2014 dhe Ligjin Nr.47/2017, Ligjin Nr.103/2018 — Neni 53, është e drejta e AK që për një gjykim sa më të drejtë dhe jo diskriminues për plotësimin e çdo Kriteri nga ana e OE pjesëmarrës, përpara shpalljes së klasifikimit përfundimtar të ofertave të bëjë si vijon:

a-verifikimin e të gjithë dokumentacionit lidhur me argumentimin e ofertës ekonomike në lidhje me Distributorin dhe Prodhuesin nga ku behet furnizimi për të gjitha pjesët e këmbimit të nevojshme për kryerjen e riparimit të mjeteve (pra të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit... sikurse kërkohet në DST)

b-verifikimin e pajisjeve dhe instrumenteve minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës kërkuar në pikën 2.3.5 të Shtojcës 7 të DST në vend (në fakt) për të gjithë autoserviset e deklaruar nga OE pjesëmarrës për këtë objekt prokurimi.

Pas kryerjes së këtyre verifikimeve të mësipërme (bazuar në LPP dhe VKM) dhe me pas marrjes së informacionit në zbatim të pikave 2.3.5 dhe 2.5.7 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit vetëm atëherë KVO duhet të bëjë riklasifikimin e ofertave për OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Përfundimisht, duke u mbështetur në LPP dhe VKM, si dhe argumentimet e paraqitura nga ana jone në këtë ankimim, kërkojmë rivlerësim të ofertave, duke skualifikuar Ofertat e paraqitura nga OE VILNIK MOTORS dhe SERVIS – AUTO 2000, pasi NUK plotësojnë të gjitha kërkesat e vendosura nga ana e Autoritetit Kontraktor, në Shtojcën 7 të DT, Kushtet e Veçanta të Kualifikimit Pika 2.3.5 dhe 2.3.7, për këtë procedure prokurimi[...]

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresës nr. 267/2 prot, datë 29.01.2021, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. duke e refuzuar atë, me arsyetimin si më poshtë:

“[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertues ekonomik “Vilnik Motors” SHPK dhe “ServisAuto 2000” SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e këtyre ofertave, konstatoi se:

Për ofertuesit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK dhe “Servis-Auto 2000” SHPK, komisioni i vlerësimit të ofertave ka njoftuar automatikisht nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik më datë 21.01.2021 kualifikimin e tyre. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga Ofertuesi “Alstezo” SHA dhe konstatoi:

Në dokumentet e tenderit në shtojcën 7 në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” pika 5, përcaktohet se operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon: a)pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjencës) së rrotave të mjetit (autovetura, fuoristrada, mikrobuza etj). b)pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo): c)pajisje diagnostikuese, të defekteve elektronike në mjete: d)pajisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C: e)pajisje për regjistrimin e ndriçimit të mjeteve: f)pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v, g)pajisje urë ngritëse për automjetet, të paktën 2 (dy) ura, h)pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorit: i)pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes: j)pajisje për zëvendësimin e vajit të motorit: k)pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit l)pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet. m)Të ketë repart të riparimit të karrocërisë të mjetit (shasisë, tapicerisë dhe përpunimit të llamarinës) si dhe bojatisjes së mjetit të pajisur me: -furre për lyerje me kapacitet për mjetet (autovetura, fuoristrada dhe furgona): -pajisje për drejtim shasie, të cilat të kenë kapacitet në përshtatje të plotë për realizimin e shërbimeve të mjeteve, sikurse kërkohet në specifikimet teknike :-reparti të jetë i kompletuar me pajisjet përkatëse (pajisjes poter për drejtim llamarinë, puntatrice, aparat saldimi, stukimi, pajisje zmerilimi dhe lucidimi). b) Për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentet që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerjeje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorjeje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ofertuesi “Vilnik Motors” SHPK rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar ofertuesi ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin “9 fatura pajisjesh” dhe “8 kontrate qiraje Alba Trans”. Pjesë e dokumentacionit janë kontrata qiraje si dhe fatura tatimore shitje me anë të të cilave vërtetohet disponimi e të gjithë pajisjeve dhe instrumente të nevojshme për zbatimin e kontratës të kërkuar në pikën 5 të seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” në shtojcën 7 në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në DST.

Kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme bazuar dhe në pikën 1, të nenit 46 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku

citohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese... ” Në nenin 53 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se :” Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”. Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit “Alstezo” SHA nuk pranohet....

....Në dokumentet e tenderit në shtojcën 7 në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” pika 5, përcaktohet se operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi “Vilnik Motors” SHPK në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka paraqitur dokumentacionin me emërtimin “14 autorizim distributori”. Nga verifikimi i autorizimit të distributorit të autorizuar nga prodhuesi, rezulton se ofertuesi “Vilnik Motors” SHPK disponon autorizim nga dy shoqëri distributore të autorizuar. Të dy këta distributor kanë vërtetuar lidhjet me kompanitë prodhuese përkatëse.

Kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme bazuar dhe në pikën 1, të nenit 46 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese... ” Në nenin 53 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit “Alstezo” SHA nuk pranohet.

Lidhur me pretendimet e ofertuesit “Alstezo” SHA ndaj vendimit për kualifikimin e ofertës së ofertuesit “Servis-Auto 2000” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, “Vilnik Motors” SHPK përmbush kriteret e kualifikimit për të cilat ngre pretendime ankimesi dhe gjendja e

tij faktike juridike pas arsyetimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e ofertuesit “Servis-Auto 2000” SHPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar. Për këtë arsye këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim. [...]”

II.6. Në datën 05.02.2020, operatori ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 374/1 prot., datë 12.02.2021, protokolluar me tonën në datën 15.02.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k. me argumentin: *“Në bazë të emërtesave dhe zërave të riparimit si dhe pjesët e këmbimit që kërkohen përkatësisht për montim gjate kryerjes së këtyre riparimeve në mjetet e ndryshme të përshkruara në Shtojcën 10 të DT, rezultojnë që të dy këta OE nuk kanë paraqitur të gjitha dokumentet e plota (pra për gjithë pjesët e këmbimit që konkurrojnë) me ane të të cilave, të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit...”* OE të sipërpërmendur kanë paraqitur autorizim të distributorit të pjesëve të këmbimit brenda vendit dhe në këtë rast, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Ndërkohe nga ana e AK NUK është verifikuar dhe nuk është provuar që të dy OE të plotësojnë kriteret e vendosura në pikën 2.3.7. Nga ana tjetër, përveç sa me sipër, distributorët nga ku furnizohen OE : VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000, nuk e provojnë me dokumente që e mbulojnë të gjithë gamen e artikujve me pjesë këmbimi të nevojshme për kryerjen e gjithë zërave të riparimit si dhe në pjesën më të madhe të artikujve NUK vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit” pra për të gjithë gamën e pjesëve të këmbimit e mjeteve të kërkuara përkatësisht në Shtojcën 10 të DT. Përfundimisht, Operatorët ekonomikë VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000 NUK plotësojnë kërkesat e vendosura në pikën 2.3.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr.7 (Loti I), pika 2.3.7 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si më poshtë vijon:

“7.Operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij”

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, rezulton se operatori ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Autorizim distributori, lëshuar nga shoqëria “Treg Auto” sh.a., i cili autorizon operatorin ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k., që të ofrojë produktet që tregton shoqëria “Treg Auto” sh.a. në procedurën e prokurimit objekt ankimi;
- Letër konfirmimi nga kompania “ABRO Industries INC”, me anë të së cilës konfirmon se shoqëria “Treg Auto” sh.a., është i autorizuar si distributor për territorin e Shqipërisë, për produktet e kompanisë ABRO;

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”*

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, Komisioni vëren se ky i fundit ka paraqitur një autorizim distributori, për të cilin është paraqitur vetëm një letër konfirmimi, që distributori është i autorizuar për territorin e Shqipërisë, për produktet e kompanisë ABRO. Komisioni gjykon se me anë të këtij dokumentacioni, operatori

ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k., nuk arrin të provojë se disponon autorizim prodhuesi/distributori për të gjitha pjesët e këmbimit të kërkuara nga autoriteti kontraktor, sidomos për sistemin e drejtimit, sistemin e qëndrueshmërisë dhe sistemin e amortizimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se, me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k., nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr.7 (Loti I), pika 2.3.7 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k. me argumentin: *“Në bazë të emërtesave dhe zërave të riparimit si dhe pjesët e këmbimit që kërkohe përkatësisht për montim gjatë kryerjes së këtyre riparimeve në mjetet e ndryshme të përshkruara në Shtojcën 10 të DT, rezultojnë që të dy këta OE nuk kanë paraqitur të gjitha dokumentet e plota (pra për gjithë pjesët e këmbimit që konkurrojnë) me ane të të cilave, të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit...”* OE të sipërpërmendur kanë paraqitur autorizim të distributorit të pjesëve të këmbimit brenda vendit dhe në këtë rast, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Ndërkohe nga ana e AK NUK është verifikuar dhe nuk është provuar që të dy OE të plotësojnë kriteret e vendosura në pikën 2.3.7. Nga ana tjetër, përveç sa më sipër, distributoret nga ku furnizohen OE : VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000, nuk e provojnë me dokumente që e mbulojnë të gjithë gamen e artikujve me pjese këmbimi të nevojshme për kryerjen e gjithë zërave të riparimit si dhe në pjesën më të madhe të artikujve NUK vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit” pra për të gjithë gamen e pjesëve të këmbimit mjeteve të kërkuara përkatësisht në Shtojcën 10 të DT. Përfundimisht, Operatoret ekonomikë VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000 NUK plotësojnë kërkesat e vendosura në pikën 2.3.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr.7 (Loti I), pika 2.3.7 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si më poshtë vijon:

“7.Operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkua, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij”

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, rezulton se operatori ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Autorizim distributori, lëshuar nga shoqëria “Edmond” sh.p.k., i cili autorizon operatorin ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k., që të ofrojë produktet që tregton shoqëria “Edmond” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, përkatësisht produktet e AISIN dhe STELLOX, shoqëruar me certifikatat e partneritetit të lëshuara nga kompanitë prodhuese;
- Autorizim distributori, lëshuar nga shoqëria “F.E.A.R” sh.p.k., i cili autorizon operatorin ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k., që të ofrojë produktet që tregton shoqëria “F.E.A.R” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, përkatësisht produktet e ContiTech, Mann Filter, Bremi, Schaeffler Automotive Aftermarket, Moll Batterien, Monark Diesel, Ruville, Siemens VDO, Spahn, Trico dhe TRË, shoqëruar me Certifikatat e partneritetit/autorizime prodhuesi të lëshuara nga kompanitë prodhuese;

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”*

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të veçantë i kualifikimit, Komisioni vëren se ky i fundit ka paraqitur dy autorizime distributori, për të cilat janë paraqitur një sërë certifikatash partneriteti/autorizime prodhuesi, të cilat janë prodhuese të pjesëve të ndryshme të këmbimit, lubrifikantëve, baterive etj., si dhe pjesëve të këmbimit të rëndësishme motorike dhe

xhenerike. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se, me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "Vilnik Motors" sh.p.k., e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr.7 (Loti I), pika 2.3.7 "Për kapacitetin teknik", të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej, në rast se ankimuesi do të kishte një pretendim për ndonjë pjesë këmbimi konkrete, atëherë duhet ta kishte bërë të identifikueshme, si dhe të kishte paraqitur argumente dhe prova konkrete, për të mbështetur pretendimet e tij.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Alstezo" sh.a. nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Alstezo" sh.a. për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Vilnik Motors" sh.p.k. me argumentin: *"A-Lidhur me pretendimin tonë për mosplotësim të kërkesave të vendosura në Piken 2.3.5, argumentojmë si vijon: Duke i njohur kapacitetet teknike të operatorëve ekonomik VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000, rezulton që të 2 këta operatorë ekonomik nuk i disponojnë në FAKT në serviset e tyre përkatëse të gjitha pajisjet e kërkuara në pikën 2.3.5 ne DST nga AK. Gjithashtu, nisur nga ky faktor, rezulton që të 2 OE : VILNIK MOTORS dhe SERVIS - AUTO 2000 nuk kanë paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) të gjitha dokumentet që vërtetojnë se, të gjitha këto pajisje dhe instrumente sa më sipër i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerjeje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorjeje / kontratë dhurimi çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, sikurse kërkohet në DST. Në kushtet e mësipërme, Operatoret ekonomik NUK i plotësojnë kërkesat e vendosura në Pikën 2.3.5, për "disponimin e pajisjeve dhe instrumenteve minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës", të vendosura Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7, ne DST nga AK", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në shtojcën nr.7 (Loti I), pika 2.3.5 "Për kapacitetin teknik", të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si më poshtë vijon:

"5.Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjences) së rrotave të mjetit (autovetura, fuoristrada, mikrobuza etj).*
- b)pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);*
- c)pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete;*
- d)pajisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C;*
- e)pajisje për regjistrimin e ndriçimit të mjeteve;*
- f)pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;*
- g)pajisje urë ngritese për automjetet, të paktën 2 (dy) ura;*
- h)pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit;*

i)pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;

j)pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;

k)pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit ;

l)pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.

m)Të ketë repart të riparimit të karrocërisë të mjetit (shasisë, tapicerisë dhe përpunimit të llamarinës) si dhe bojatisjes së mjetit të pajisur me :

-furre për lyerje me kapacitet për mjetet (autovetura, fuoristrada dhe furgona);

-pajisje për drejtim shasie, të cilat të kenë kapacitet në përshtatje të plotë për realizimin e shërbimeve të mjeteve, sikurse kërkohet në specifikimet teknike ;

-reparti të jetë i kompletuar me pajisjet përkatëse (pajisjes për drejtim llamarinë, puntatrice, aparat saldimi, stukimi, pajisje zmerilimi dhe lucidimi).

Për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerjeje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorjeje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë)”

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, rezulton se operatori ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë qiraje, nr.2306rep., nr.788kol., datë 22.07.2020, lidhur ndërmjet shoqërisë “Alba-Trans” sh.p.k. në cilësinë e qiradhënësit dhe operatorit ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira të disa pajisjeve për servis automjetesh, shoqëruar me dokumentacionin që vërteton disponimin nga shoqëria “Alba-Trans” sh.p.k. të këtyre pajisjeve;

- Fatura tatimore shitje nr.100; nr.11; nr.231; nr.310; nr.153; nr.177; nr.18; nr.202; nr.87; nr.111; nr.152; nr.139; nr.374; nr.6; nr.5;

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”

III.4.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon autoriteti kontraktor, duke qenë se

është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitetet e duhura teknike, për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, Komisioni vëren se ky i fundit ka paraqitur kontratë qiraje nr.2306rep., nr.788kol., datë 22.07.2020, me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje bangoje provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo)”* dhe *“pajisje për drejtim shasie”*; faturë tatimore nr.100 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjençës) së rrotave të mjetit (autovetura, fuoristrada, mikrobuza etj)”* dhe 4 *“pajisje urë ngritese për automjetet”*; faturë tatimore nr.11 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje diagnostikuese, të defekteve elektronike në mjete”*; faturë tatimore nr.231 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C”*; faturë tatimore nr.153 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje për regjistrimin e ndriçimit të mjeteve”*; faturë tatimore nr.177 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v”* dhe 3 *“pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit”*; faturë tatimore nr.18 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorit”*; faturë tatimore nr.202 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes”*; faturë tatimore nr.87 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit”*; faturë tatimore nr.111 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet”*; faturë tatimore nr.152 me anë të së cilës vërteton se disponon *“furra për lyerje me kapacitet për mjetet (autovetura, fuoristrada dhe furgona)”*; faturë tatimore nr.5 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje poter për drejtim llamarinë”, “pajisje stukimi”, “pajisje zmerilimi” dhe “pajisje lucidimi”*; faturë tatimore nr.374 me anë të së cilës vërteton se disponon *“pajisje puntatrice”*; faturë tatimore nr.139 me anë të së cilës vërteton se disponon *“aparaturë saldimi”*. Sa më sipër, Komisioni konstaton se me dokumentacionin e dorëzuar, arrin të vërtetojë se i disponon të gjitha pajisjet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k., e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr.7 (Loti I), pika 2.3.5 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”* Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. për proçedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Loti I “Riparim dhe mirëmbajtjeje automjetesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me nr. REF-83258-12-28-2020, me fond limit 4,291,055 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.01.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “*Servis – Auto 2000*” sh.p.k dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 196 Protokolli Datë 05.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

MENDIM PARALEL

Mendim paralel i anëtares të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Vilma Zhupaj (Anëtare), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtare e KPP, shpreh mendimin tim lidhur me arsyetimin dhe qëndrimin e shumicës, përsa i përket marrjes në shqyrtim të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Servis – Auto 2000” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Loti I “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””, me nr. REF-83258-12-28-2020, me fond limit 4,291,055 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.01.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj:

III.1.Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a., mbi vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k. dhe “Servis – Auto 2000” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, gjykoj se:

III.1.1. Vlerësoj të sjell në vëmendje se, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit të afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës”, ku ndër të tjera janë faktet dhe provat në të cilat bazohet ankesa”

III.1.2. Gjykoj se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashirojnë pretendime a-priori duke iu referuar kritereve të veçanta të kualifikimit duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështeten pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “ Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “onus probandi incumbit actori” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, gjykoj se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjithë elementët proceduralë, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, neni 21 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikon se: “ Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”, ndërkohë në

nenin 25 të tij parashikohet se “ Pa cënuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.”

III.1.3. Sa më sipër, gjykoj se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksoj se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë dhe jo të shprehë vetëm mosplotësimin e tyre në mënyrë të paargumentuar. Theksoj se, mospërmbushja e kriterit mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, ka një dallimin të qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilido operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efincencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krahasim të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.1.6. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk duhet të merret në shqyrtim nga KPP. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një *quasi* gjykatë dhe duhet të

refuzojë të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik ankimues duhet të mospranohet tërësisht.

Anëtar

Vilma Zhupaj